

STATUTI

Shoqata “LIQENI I BREZNËS”

1. Informacionet bazë

Shoqata “Liqeni i Breznës”

Rr. Vëllezërit Frasheri 83
20260 Brezne / Dragash
Kosovë

Tel: +383 49 486 979

shoqata@brezne.com

www.brezne.com

Lloji

OJQ – Organizatë jofitimprurëse

Nr. i regjistrimit

Kryesia

Erim Krasniqi
(Kryetar)

Laurat Krasniqi
(Arkëtar)

Granit Gashi
(Sekretar)

Data dhe vendi

02.05.2025
f.sh. Brezne
Kosovë

2. Dispozitat themelore

Neni 1

Ky statut përcakton rregullat e organizimit, funksionimit dhe të veprimtarisë së shoqatës Liqeni i Breznës, shkurtesa zyrtare e së cilës është SH.L.B.

Neni 2

Dispozitat e këtij statuti zbatohen nga Kuvendi i Anëtarëve të shoqatës dhe të gjithë personat e angazhuar për dhe rreth veprimtarisë së shoqatës Liqeni i Breznës.

Neni 3

3.1 Ky statut është dokumenti kryesor i shoqatës Liqeni i Breznës

3.2 Shoqata “Liqeni i Breznës” zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.

3.3 Të gjitha dokumentet zyrtare të shoqatës duke përfshirë rregulloret, procedurat, manualët dhe politikat zhvillimore janë në përputhje me këtë Statut dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 4

4.1 Shoqata “Liqeni i Breznës” është organizatë joprotabile, e cila në përputhje me përkufizimin e dhënë në Nenin 16 dhe Nenin 19.1 (1.1) të Ligjit Nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (Në tekstin e mëtejshëm: Ligji), ka formën e organizimit si Shoqatë.

4.2 Webfaqja zyrtare është portali i përbashkët i fshatit Brezne www.brezne.com ku shoqata ka hapësirën e veçantë tek linku me url www.brezne.com/shoqata

4.3 Hapësirën nga Neni 4.2 dhe mjetet tjera të informimit, ndahen së bashku me shoqatën simotër me seli në Zvicër.

Neni 5

Parimi për jo përfitim

5.1 Shoqata nuk shpërndan të ardhura ose fitime për asnjë person.

5.2 Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e Shoqatës përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të saj.

5.3 Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e Shoqatës nuk përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar të Kuvendit, punonjës ose donatorë të Shoqatës, përveç pagesës për personat e punësuar që kryejnë punë për shoqatën.

5.4 Shoqata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse, në pajtim me Nenin 35 të Ligjit, me kusht që të ardhurat e realizuara përmes aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në këtë Statut.

Neni 6

Konflikti i interesit dhe detyrimi në lojalitet

6.1 Asnjë anëtar i të organit drejtues nuk i lejohet të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje kur ai ka interes privat të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit.

6.2 Çdo transaksion ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, të punësuarit, anëtarëve të bordit apo të organizatave të ndërlidhura, kryhet sipas vlerës së tregut ose në kushtet më të favorshme për OJQ-në.

6.3 Të gjithë anëtarët dhe të punësuarit tjerë të një OJQ-je, obligohen që të tregojnë lojalitet ndaj OJQ-së, të mbrojnë fshehtësinë e informatave jo-publike dhe interesat e OJQ-së, si dhe të ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre me mirëbesim dhe kujdes.

Neni 7

Transaksionet financiare të Shoqatës

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e shoqatës, kryhen nëpërmjet institucioneve financiare të licencuara nga BQK në llogaritë bankare të hapura në emër të shoqatës, përveç rasteve të lejuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 8

Ndalimi i mbledhjes së fondeve, fushatave dhe mbështetjes së kandidatëve dhe partive politike

Organizata nuk mund të angazhohet në mbledhje fondesh ose në fushata për të mbështetur partitë politike ose kandidatët për funksione politike dhe as nuk mund të propozojë, regjistrojë kandidatë për poste politike.

3. Qëllimi dhe fushëveprimi i shoqatës

Neni 9

Qëllimi i shoqatës

9.1 Shoqata ka si qëllim primar bashkëpunimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të ndryshme përmes iniciativave individuale apo grupe që shkojnë në interes të fshatit Brezne.

9.2 Shoqata ka qëllimet e përbashkëta me shoqatën simotër me seli në Zvicër e cila qëndron si shoqatë urë lidhëse për bashkëpunimin e të gjithë banorëve që kanë lidhje me fshatin Brezne.

Neni 10

Fushëveprimi i shoqatës

10.1 Shoqata, për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik, ka këtë fushëveprim:

- a) Koordinimin e aktiviteteve me shoqatën simotër “Liqeni i Breznës” në Zvicër
- b) Ekzekutimin e iniciativave të ndërmarra nga aktivistët e shoqatës si dhe përkrahësit tjerë që kanë qëllime pozitive për fshatin Brezne
- c) Ruajtja e vlerave kulturore me të gjithë banorët kudo që jetojnë
- d) Kujdesi ndaj ambientit që e rrethon fshatin Brezne
- e) Përkrahja e aktiviteteve në zhvillimin socio-ekonomik të fshatit Brezne

4. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i shoqatës

Neni 11

Strukturat udhëheqëse

11.1 Strukturat udhëheqëse të Shoqatës janë:

- a) Kuvendi
- b) Bordi drejtues (Kryesia)
 - a. Kryetari
 - b. Arkëtari
 - c. Sekretari
- c) Aktivistët
- d) Grupet tjera

Neni 12

Kuvendi

12.1 Kuvendi është organi më i lartë qeverisës i shoqatës, i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqatës.

12.2 Kuvendi ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të shoqatës. Në këtë kuadër, Kuvendi ka kompetencë të zgjedhë dhe të shkarkojë anëtarët e organit të ndërmjetëm, të aprovojë raportet periodike financiare dhe të punës, të

interpretojë dhe ndryshojë Statutin, si dhe të vendosë për bashkimin, ndarjen apo shuarjen e Shoqatës. Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen në organin e ndërmjetëm.

12.3 Kuvendi, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij, mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në organin e ndërmjetëm, me përjashtim të përgjegjësive të cilat nuk delegohen sipas nenit 31 të Ligjit dhe paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 13

Anëtarësimi në shoqatë

13.1 Kushtet e anëtarësimit në shoqatë janë:

- a) Të pranojë Statutin e organizatës;
- b) Të angazhohet për përmbushjen e qëllimeve të organizatës;

13.2 Anëtarësimi në shoqatë është i hapur për çdo person që i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, pavarësisht prej racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

13.3 Kuvendi i anëtarëve vendosë nëse kërkohet pagesa e anëtarësimit nga anëtarët.

13.4 Anëtarësimi në shoqatë përfundon kur anëtari/anëtarja:

- a) nuk vazhdon t'i përmbushë kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni;
- b) nuk vazhdon t'i përmbushë kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni;
- c) dënohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale;
- d) përjashtohet nga shoqata me vendim të Kuvendit të Anëtarëve;

13.5 Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të mosrespektimit të statudit të shoqatës. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit përcaktohet nga Kuvendi.

13.6 Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve vendoset me shumicë të anëtarëve prezent.

Neni 14

Detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit

14.1 Kuvendi mbikëqyrë punën e përgjithshme të Shoqatës dhe ka përgjegjësi të plotë për çështje të politikave zhvillimore dhe financiare të Shoqatës.

14.2 Kuvendi takohet të paktën një (1) herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV), ku shqyrton dhe miraton raportin financiar dhe të veprimtarisë së shoqatës për vitin paraprak, si dhe planin e veprimtarisë së punës dhe aktiviteteve të shoqatës për vitin vijues.

14.3 Kuvendi mund të takohet edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ), kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga organi i ndërmjetëm. Kërkesa për mbledhje të përgjithshme të jashtëzakonshme i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit të Anëtarëve, i cili lajmëron të gjithë anëtarët për takimin, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Rregulloren e brendshme të punës së shoqatës.

14.4 Përveç kësaj, Kuvendi ka kompetencat si në vijim:

- a) përcakton dhe mbikëqyrë përmbushjen e ligjshme të qëllimit të Shoqatës;
- b) pranon anëtarët e shoqatës;
- c) zgjedh dhe shkarkon organin e ndërmjetëm të Shoqatës;
- d) zgjedh dhe shkarkon përfaqësuesin e autorizuar të Shoqatës;
- e) miraton strategjinë e veprimit të Shoqatës, si dhe dokumentet tjera të rëndësishme strategjike të shoqatës;
- f) aprovon raportet periodike financiare dhe të punës, kur të njëjtat kërkohen nga Kuvendi apo paraqiten nga organet tjera të shoqatës;
- g) vendos për bashkim, ndarje apo shuarje të Shoqatës.

Neni 15

Përfaqësuesi i autorizuar

15.1 Shoqata cakton me shkrim përfaqësuesin e autorizuar, i cili është rezident në Republikën e Kosovës, sipas nenit 23 të Ligjit.

15.2 Përfaqësuesi i autorizuar i Shoqatës zgjedhet me mandat 1 vjeçar me të drejtë të ri-zgjedhjes.

15.3 Përfaqësuesi i autorizuar i Shoqatës ka përgjegjësitë si në vijim:

- a) përfaqëson shoqatën pranë autoriteteve relevante;
- b) pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të Shoqatës;
- c) është përgjegjës për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi në Shoqatë;
- d) është përgjegjës për hapjen dhe administrimin e llogarisë bankare në emër të Shoqatës;
- e) i raporton organit i cili e ka zgjedhur.

15.4 Përfaqësuesi mund të shkarkohet nga Kuvendi me 50+1% të votave të anëtarëve të tij, në rast se ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës së tij/saj.

Neni 16

Zyrtari kryesor ekzekutiv

16.1 Shoqata mund të angazhoj edhe persona tjerë për të kryer punën për organizatën.

16.2 Zyrtari kryesor ekzekutiv i shoqatës zgjedhet dhe shkarkohet nga Kuvendi.

16.3 Përgjegjësitë e zyrtarit kryesor ekzekutiv të shoqatës janë:

- a) është përgjegjës për planifikimin, zbatimin dhe koordinimin e punës së gjithmbarshme të Shoqatës të përcaktuar me këtë Statut;
- b) është përgjegjës për administrimin e sistemeve administrative, financiare, logjistike dhe personelit të Shoqatës;
- c) zhvillon procedurat e punësimit, mbikëqyrë marrëdhënien e punës, vlerëson performancën e të punësuarve, dhe ndërprejë marrëdhënien e punës sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë;
- d) siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të Kuvendit në mënyrë efektive dhe efikase;
- e) kryen detyrat dhe përgjegjësitë tjera të caktuara nga Kuvendi, të përcaktuara në këtë statut ose ligjet apo aktet tjera nënligjore në fuqi.

Neni 17

Organi i ndërmjetëm

17.1 Bazuar në përgjegjësitë e dhëna me këtë statut, organi udhëheqës i ndërmjetëm, “Bordi Drejtues” vepron çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.

17.2 Bordi drejtues do të ketë këto përgjegjësi:

- a) Përpilimin dhe përmirësimin e rregullores gjatës mandatit të parë
- b) Organizimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve
- c) Koordinimin me shoqatën simotër në Zvicër
- d) Koordinimin dhe bashkëpunimin me aktorët tjerë

17.3 Bordi drejtues zgjedhet nga Kuvendi i Shoqatës. Anëtarët do të zgjidhen individualisht me shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm. Mënyra e zgjedhjes dhe rregullat e punës së anëtarëve të bordit drejtues mund të rregullohen me Rregullore të veçantë për punën e bordit drejtues, e cila aprovet nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë votash.

17.4 Bordi drejtues ka të paktën 3 (tre) anëtarë, njëri nga të cilët duhet të zgjedhet si Kryesues i këtij organi.

17.5 Mandati i anëtarëve të bordit drejtues zgjat 1 vit, të cilët mund të zgjedhen për mandate të njëpasnjëshme.

17.6 Anëtarët e bordit drejtues mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me shumicë votash të Kuvendit të Shoqatës.

17.7 Mandati i bordit drejtues pushon në rast të:

- a) vdekjes,
- b) dorëheqjes
- c) dënohet me vendim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale ose
- d) shkarkimit nga Kuvendi i Anëtarëve.

17.8 Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të anëtarit të bordit drejtues, Kuvendi i Shoqatës zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur me mandat të ri.

17.9 Vendimet e bordit drejtues merren me shumicë votash të anëtarëve prezent.

17.10 Bordi drejtues mund të vendosë t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.

17.11 Kurrfarë pagese ose kompensimi nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të bordit drejtues pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompensimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.

17.12 Asnjë anëtar i bordit drejtues nuk i lejohej të marrë pjesë në diskutim apo në marrjen e vendimit për çështje ku ai ka interes direkt apo indirekt ekonomik. Anëtar i bordit drejtues konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo, ose cilido anëtar i familjes së tij ka interes direkt apo indirekt ekonomik.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe organeve të zgjedhura nga Kuvendi dhe të punësuarave zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me Statutin dhe rregullat e brendshme të Shoqatës, në të kundërtën çështja zgjedhet nga gjykata kompetente.

Neni 19

19.1 Bordi drejtues dhe Zyrtarët përgjegjës paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ose kurdoherë që kërkohet në një Mbledhje të Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ).

19.2 Viti financiar i organizatës përputhet me vitin kalendarik.

5. Dispozitat përfundimtare

Neni 20

Rregullorja e punës

Kuvendi i shoqatës në pajtim me këtë Statut dhe legjislacionin përkatës në fuqi, aprovon rregullore të punës për mënyrën e vendimmarrjes dhe veprimtarinë e vet.

Neni 21

Shpërbërja

21.1 Shoqata mund të shpërbëhet me vendimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 22

Hyrja në fuqi

22.1 Ky Statut mund të ndryshohet me dy të tretat (2/3) e votave të Anëtarëve të Kuvendit të shoqatës.

22.2 Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Anëtarëve.

Ky Statut është miratuar në Brezne më 02.05.2025

Kryetari:

Erim Krasniqi

Statuti është dizajnuar nga kryesia e shoqatës “Liqeni i Breznës”

© 2025 Shoqata “Liqeni i Breznës”